



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria për Zhvillimit Rural

THIRRJE PËR APLIKIM PËR PJESËMARRJE NË TREGUN MOBIL

Ftohen të gjithë fermerët të cilët janë prodhues të produkteve bujqësore të aplikojnë për pjesëmarrje në tregun mobil në komunën e Prishtinës.

Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët/aplikantët:

1. Fermerët aplikues duhet të jenë prodhues apo përpunues të produkteve bujqësore;
2. Fermerët të cilët veprimtarinë bujqësore e ushtrojnë në territorin e komunës së Prishtinës do të kenë përparësi;
3. Fermerët me prodhimtari dhe llojshmëri më të madhe të prodhimeve bujqësore do të kenë përparësi;
4. Fermerët të cilët bujqësinë e kanë aktivitet primarë në të hyra familjare do të kenë përparësi;
5. Në kushte të barabarta gratë fermere dhe grupet e marginalizuara do të kenë përparësi;
6. Fermerët të cilët nuk e kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë tokë me qira, duhet të kenë marrëveshje kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët;
7. Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
8. Fermerët nuk kanë të drejtë ekspozimi të produkteve jo-bujqësore.
9. Përparësi kanë fermerët që kanë qenë të rregullt në vitin e kaluar.

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
2. Numri identifikues i fermerit (NIF);
3. Marrëveshja për marrjen e tokës me qira në mes palëve, atëherë kur fermeri deklaron se aktivitetin e realizon në tokë me qira.

VËREJTJE

Nëse komisioni parasheh të nevojshme të kërkojë dokumente shtesë të cilat mundësojnë përzgjedhjen e përfituesve. Aplikantët (fermerët) janë të obliguar t'i sjellin brenda afatit, në të kundërtën humbin të drejtën për të qenë përfitues.

Aplikimi bëhet nga 13/05/2025 deri 20/05/2025, në sportele, në objektin e komunës së vjetër.